

UDHËZIM
Nr. 8, datë 20.5.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E KOSTOVE TË PRANUESHME, QË MBËSHTETEN NGA
NDËRHYRJET STRUKTURE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”,

UDHËZOJ:

1. Përcaktimin e veprimtarive dhe të kostove të pranueshme, që mbështeten nga ndërhyrjet strukturore, me qëllim:

- a) përmirësimin e higjienës, sigurisë dhe kushteve të punës për peshkatarët;
- b) mbrojtjen dhe rimëkëmbjen e biodiversitetit dhe ekosistemeve detare, si dhe një regjim kompensimi, në kuadër të aktiviteteve të qëndrueshme të peshkimit;
- c) përmirësimin e efikasitetit energjetik të anijeve të peshkimit dhe zvogëlimin e efekteve të ndryshimeve klimatike.

2. Kostot e mirëmbajtjes të çfarëdo pajisjeje përjashtohen nga kostot e pranueshme që mbështeten nga ndërhyrjet strukturore.

3. Në kostot e pranueshme që mbështeten nga ndërhyrjet strukturore përfshihen kostot e nevojshme për instalimin e pajisjeve të përfshira në këtë udhëzim.

4. Për veprimtaritë që synojnë përmirësimin e sigurisë së peshkatarëve në bordin e anijeve të peshkimit do të mbështeten nga ndërhyrjet strukturore kostot për blerjen dhe, kur është e mundur, instalimin e pajisjeve të listuara, si më poshtë:

- a) gomone shpëtimi;
- b) njësi çlirimi hidrostatik për gomonet e shpëtimit;
- c) transmetues personal të vendndodhjes si Transmetuesi Radio i Emergjencës për Përcaktimin e Vendndodhjes (EPIRB), të cilat mund të integrohen në jelekët e shpëtimit dhe rrobat e punës së peshkatarëve;
- ç) pajisjet për pluskimin vetjak (PFD), në veçanti kostume për zhytje ose mbijetesë kamerdare shpëtimi dhe jelek shpëtimi;
- d) sinjalizues emergjence;
- dh) pajisje për lëshimin e litarëve;
- e) sisteme për rikuperimin e personave në det;
- ë) pajisje zjarrfikëse, si: shuajse zjarri, batanije kundër zjarrit, detektorë zjarri dhe tymi, respiratorë;
- f) dyer për mbrojtjen nga flakët;
- g) valvulat për ndërprerjen e karburantit;
- gj) sistem për detektimin e gazit dhe sinjalizues gazi;
- h) pompa për largimin e ujit dhe alarmet përkatës;
- i) pajisjet për komunikimin satelitor dhe radio;
- j) dyer kundër ujit;
- k) pajisje mbrojtëse të makinerive, si: çikrikët ose tamburet për tërheqjen e rrjetave;
- l) korridore ose shkallë akses;
- ll) pajisje për ndriçim, përfshirë këtu edhe dritat e emergjencës;
- m) mekanizma për lëshimin e sigurt, në rastet kur një vegël peshkimi ka zënë objekte që e bllokojnë atë;

n) kamera dhe monitorë sigurie;

nj) pajisje dhe elementet e nevojshme për përmirësimin e sigurisë mbi kuvertë.

5. Për veprimtaritë ose sigurimin me pajisje, që synojnë përmirësimin e kushteve shëndetësore të peshkatarëve në bordin e anijeve të peshkimit, do të mbështeten nga ndërhyrjet strukturore kostot, si më poshtë:

a) blerja dhe instalimi i kutive të ndihmës së shpejtë;

b) blerja e medikamenteve dhe e pajisjeve për trajtime urgjente në bordin e anijes;

c) sigurimi me pajisje telemjekësie, duke përfshirë teknologjitë elektronike, pajisjet e imazherisë diagnostike të aplikuara në konsulta mjekësore në distancë, nga bordi i anijes;

ç) pajisja me manuale dhe udhëzues për përmirësimin e kushteve shëndetësore në bord;

d) fushata informuese për përmirësimin e kushteve shëndetësore në bord.

6. Për veprimtaritë ose sigurimin me pajisje, që synojnë përmirësimin e kushteve higjienike të peshkatarëve në bordin e anijeve të peshkimit, do të mbështeten nga ndërhyrjet strukturore kostot për blerjen dhe, kur është e mundur, instalimin e pajisjeve të listuara, si më poshtë:

a) objektet sanitare, si tualete ose objektet për larjen;

b) kuzhinë dhe pajisje për ruajtjen e ushqimeve objektet dhe pajisjet e kuzhinës për ruajtjen e ushqimeve;

c) pajisje për pastrimin e ujit të pijshëm;

ç) pajisje pastrimi për përmirësimin e kushteve sanitare në bord;

d) udhëzues dhe manuale për përmirësimin e kushteve higjienike në bord.

7. Për veprimtaritë ose sigurimin me pajisje, që synojnë përmirësimin e kushteve të punës në bordin e anijeve të peshkimit, do të mbështeten nga ndërhyrjet strukturore kostot për blerjen dhe, kur është e mundur, instalimin e pajisjeve të listuara, si më poshtë:

a) vendosja e kangjellave dhe të bordurave mbi kuvertën e anijes;

b) struktura për mbrojtjen mbi kuvertën e anijes, si dhe modernizimi i kabinave për t'u mbrojtur nga kushtet e këqija të motit;

c) pajisjet për përmirësimin e sigurisë në kabina dhe në ambientet e përbashkëta të ekuipazhit;

ç) pajisjet për reduktimin e ngritjeve manuale të ngarkesave të rënda, duke përjashtuar makineritë e lidhura drejtpërdrejt për aktivitetin e peshkimit si çikrikët;

d) bojërat dhe çizme gome kundër rrëshqitjes;

dh) pajisje për mbrojtjen akustike dhe termike, si dhe mjete ndihmëse për ventilim;

e) veshje pune dhe pajisje sigurie, si: çizme sigurie kundër ujit, pajisje mbrojtëse për sytë dhe sistemin e frymëmarrjes, dorezat dhe helmetat mbrojtëse ose pajisjet për mbrojtjen nga rënia;

ë) sinjalistikë paralajmëruese të emergjencës dhe të sigurisë;

f) analiza dhe vlerësimi i riskut për të identifikuar rreziqet me të cilat përballen peshkatarët, si në port ashtu edhe në det, me qëllim marrjen e masave për parandalimin ose zvogëlimin e tyre;

g) udhëzues dhe manuale për përmirësimin e kushteve të punës në bord.

8. Për veprimtaritë e lidhura me grumbullimin e mbetjeve nga peshkatarët në det, do të mbështeten nga ndërhyrjet strukturore kostot për sa më poshtë:

a) grumbullimin e veglave të peshkimit të humbura në det;

b) blerjen dhe, nëse është e nevojshme, instalimin në bord të pajisjeve të grumbullimit dhe të depozitimit të mbetjeve;

c) ngritjen e programeve të grumbullimit të mbetjeve për peshkatarët pjesëmarrës, duke përfshirë stimujt financiarë;

ç) blerjen dhe, sipas rastit, instalimin në portet e peshkimit të sistemeve të magazinimit dhe riciklimit të mbetjeve;

d) fushata komunikimi, informimi dhe ndërgjegjësimi për të nxitur peshkatarët dhe palët e tjera të interesuara për të marrë pjesë në projekte për grumbullimin e veglave të humbura të peshkimit;

dh) trajnime për peshkatarët dhe agjentët e portit.

9. Për veprimtaritë e lidhura me ndërtimin, instalimin ose modernizimin e pajisjeve statike ose të lëvizshme do të mbështeten nga ndërhyrjet strukturore, kostot si më poshtë:

a) blerja dhe, sipas rastit, instalimi i objekteve për mbrojtjen e zonave detare nga gjuetia fundore;

b) blerja dhe, sipas rastit, instalimi i objekteve për rimëkëmbjen e ekosistemeve detare të degraduara;

c) për punë paraprake, si: kërkimi, studime shkencore ose vlerësime;

ç) blerja dhe, sipas rastit, instalimi i pajisjeve të ankoruara për grumbullimin e peshqve, të cilat kontribuojnë në një peshkim të qëndrueshëm dhe selektiv.

10. Për veprimtaritë e përcaktuara në pikën 9 të këtij udhëzimi, nuk do të mbështeten nga ndërhyrjet strukturore kostot, për sa më poshtë:

a) blerjen e një anijeje për t'u zhytur dhe për ta përdorur si taban artificial;

b) ndërtimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve për grumbullimin e peshkut, me përjashtim të kostove të përmendura në pikën 9, shkronja "ç" të këtij udhëzimi.

11. Për veprimtaritë, që synojnë menaxhimin dhe ruajtjen më të mirë të burimeve biologjike detare do të mbështeten nga ndërhyrjet strukturore, kostot për blerjen dhe, sipas rastit, për instalimin e objekteve, si më poshtë:

a) grepa rrethorë;

b) pajisje parandaluese akustike të montuara në rrjeta;

c) pajisje për përjashtimin e breshkave detare;

ç) kavo të pajisura me flamuj;

d) mjete ose pajisje të tjera efektive në parandalimin e zënieve aksidentale të specieve të mbrojtura.

12. Nga ndërhyrjet strukturore do të mbështeten, gjithashtu, kostot, për sa më poshtë:

a) trajnime për peshkatarët lidhur me menaxhimin dhe ruajtje më të mirë të burimeve biologjike detare;

b) projekte që fokusohen në habitatet bregdetare me rëndësi për peshqit, shpendët dhe organizmat e tjerë;

c) projekte me fokus zonat bregdetare me rëndësi për riprodhimin e peshqve, si ligatinat.

13. Do të mbështeten nga ndërhyrjet strukturore kostot për zëvendësimin e veglave të peshkimit, ekzistuese me impakt të ulët, si kurthet dhe peshkimi në kallama me përdorim të karremave.

14. Për veprimtaritë e lidhura me përgatitjen e planeve të ruajtjes dhe menaxhimit të aktiviteteve të lidhura me peshkimin, do të mbështeten nga ndërhyrjet strukturore kostot, për sa më poshtë:

a) kryerjen e studimeve, veçanërisht për monitorimin dhe mbikëqyrjen e specieve dhe të habitateve, duke përfshirë hartëzimin dhe menaxhimin e rrezikut;

b) hartëzimin e aktivitetit dhe të intensitetit të peshkimit dhe ndërveprimeve me speciet dhe habitatet e mbrojtura;

c) konsultimin me palët e interesuara gjatë përgatitjes së planeve të menaxhimit;

ç) përcaktimin dhe zbatimin e treguesve të presionit dhe ndikimit të peshkimit dhe kryerjen e vlerësimeve të statusit të ruajtjes;

d) trajnimin e peshkatarëve dhe organeve të tjera përgjegjëse për menaxhimin e zonave detare të mbrojtura, të interesuar në përgatitjen e planeve të ruajtjes dhe të menaxhimit të aktiviteteve të lidhura me peshkimin;

dh) përcaktimin e zonave të mbrojtura detare;

e) mbikëqyrjen, duke përfshirë shpërblimin e personelit të angazhuar në këtë aktivitet;

- ë) reklamimin dhe ndërgjegjësimin për zonat e mbrojtura detare;
- f) vlerësimin e impaktit të planeve të menaxhimit në zonat *Natura 2000* dhe në zonat e peshkimit.

15. Për veprimtaritë e lidhura me menaxhimin, rimëkëmbjen dhe monitorimin e zonave *Natura 2000* dhe të zonave të mbrojtura detare, do të mbështeten nga ndërhyrjet strukturore kostot, për sa më poshtë:

- a) konsultimin e palëve të interesuara në fazën e përgatitjes së planeve të menaxhimit;
- b) përcaktimin dhe zbatimin e treguesve të presionit/ndikimit dhe vlerësimet e statusit të ruajtjes;
- c) mbikëqyrjen e zonave *Natura 2000* dhe zonave të mbrojtura detare;
- ç) trajnimin për organet përgjegjëse në menaxhimin e zonave *Natura 2000* dhe të zonave të mbrojtura detare;
- d) trajnimin e peshkatarëve në ruajtjen dhe rimëkëmbjen e ekosistemeve detare, si dhe mbi aktivitetet alternative të lidhura me to, të tilla si ekoturizmi në zonat *Natura 2000* dhe zonat e mbrojtura detare;
- dh) hartëzimin e aktivitetit të peshkimit, monitorimin e intensitetit dhe regjistrimin e ndërveprimeve të tij me speciet e mbrojtura, si: foka, breshkat e detit, delfinët dhe apo shpendët detarë;
- e) mbështetjen për përcaktimin e masave të menaxhimit të peshkimit në zonat *Natura 2000* dhe në zonat e mbrojtura detare, si p.sh. studimet mbi vlerësimin e ndikimit dhe rrezikut;
- ë) mbështetjen për masat e ndërgjegjësimit mjedisor, duke përfshirë peshkatarët në mbrojtjen dhe rimëkëmbjen e biodiversitetit detar;
- f) bashkëpunimin midis menaxherëve të zonave *Natura 2000* dhe zonave të mbrojtura detare.

16. Për veprimet e lidhura me pjesëmarrjen në veprime të tjera, që synojnë ruajtjen dhe promovimin e biodiversitetit dhe shërbimeve në ekosistem, do të mbështeten nga ndërhyrjet strukturore kostot, për sa më poshtë:

- a) Për skema për të testuar teknika të reja monitoruese, më konkretisht:
 - i. sistemet e kontrollit elektronik në distancë, të tilla si kamerat CCTV, për monitorim dhe regjistrimi i zënieve aksidentale të llojeve të mbrojtura;
 - ii. regjistrimi i të dhënave oqeanografike, si temperatura, kripësia, planktoni, përhapja e algave ose turbullira;
 - iii. hartëzimi i specieve invazive;
 - iv. veprime, edhe në formën e studimeve, për të parandaluar dhe kontrolluar përhapjen e specieve invazive;
- b) Stimuj financiarë për instalimin e pajisjeve automatike të regjistrimit në bord për monitorimin dhe regjistrimin e të dhënave oqeanografike, si temperatura, kripësia, planktoni, përhapja e algave ose turbullira;
- c) dhënia me qira e anijeve tregtare të peshkimit, për qëllime vëzhgimi mjedisor në një shkallë proporcionale me aktivitetin;
- ç) veprime të tjera shkencore të hartëzimit dhe vlerësimit të ekosistemeve detare dhe bregdetare dhe shërbimeve të tyre.

17. Për veprimet që synojnë rimëkëmbjen e habitateve specifike detare dhe bregdetare në mbështetje të resurseve peshkore të qëndrueshme do të mbështeten nga ndërhyrjet strukturore kostot, për sa më poshtë:

- a) reduktimin e ndotjes fizike dhe kimike;
- b) reduktimin e faktorëve të tjerë fizik, duke përfshirë zhurmën nënujore të cilat ndikojnë negativisht në biodiversitetet;
- c) masat pozitive të ruajtjes, që synojnë mbrojtjen dhe ruajtjen e florës dhe faunës, duke përfshirë ripopullimin me specie autoktone;

ç) veprimet për të parandaluar, kontrolluar dhe eliminuar speciet invazive.

18. Për veprimet e lidhura me hidrodinamikën e skafit të anijeve, do të mbështeten nga ndërhyrjet strukturore kostot, për sa më poshtë:

a) investimet në mekanizmat e qëndrueshmërisë, të cilat ndihmojnë në përmirësimin e aftësisë notuese dhe stabilitetit;

b) përdorimin e *antifouling* jotoksike, të tilla si veshje bakri, për të reduktuar fërkimin;

c) mjetet e drejtimit, të tilla si sistemet e kontrollit të mjeteve drejtuese dhe timonët e shumtë për të reduktuar aktivitetin e timonit, sipas kushteve të motit dhe detit;

ç) teste për të ofruar një bazë për përmirësimin e hidrodinamikës.

19. Kostot për riparime bazë të skafit përfshihen në mbështetjen nga ndërhyrjet strukturore.

20. Për veprimet që synojnë përmirësimin e sistemit të shtytjes së anijeve do të mbështeten nga ndërhyrjet strukturore kostot, për sa më poshtë:

a) helika me eficiencë energjetike, duke përfshirë edhe boshtet;

b) katalizatorët;

c) gjeneratorë me eficiencë energjetike, për shembull me përdorim hidrogjeni ose gazi natyror;

ç) sisteme shtytëse me energji të rinovueshme, të tilla si velat, balona, turbinat ose panelet diellore;

d) helika të bashit;

dh) konvertimin e motorëve me biokarburant;

e) ekonometra, sistemet e menaxhimit të karburantit dhe sistemet e monitorimit;

ë) investime në mantele për të përmirësuar sistemin e shtytjes.

21. Për investimet në veglat e peshkimit dhe pajisjet do të mbështeten nga ndërhyrjet strukturore kostot, për sa më poshtë:

a) zëvendësimin e veglave me tërheqje me vegla alternative;

b) modifikime në veglat me tërheqje;

c) investimet në pajisjet për monitorimin e veglave me tërheqje.

22. Për investimet, që synojnë reduktimin e konsumit të energjisë elektrike dhe termike, do të mbështeten nga ndërhyrjet strukturore kostot, për sa më poshtë:

a) investime në përmirësimin e sistemeve të ftohjes, ngrirjes apo termoizolimit të anijeve më të vogla se 18 m;

b) investime në promovimin e riciklimit të nxehtësisë në anije, nëpërmjet rikuperimit dhe ripërdorimit për operacione të tjera ndihmëse në bord.

23. Ngarkohet drejtoria përgjegjëse për politikat e peshkimit, drejtoria përgjegjëse për buxhetin dhe Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural për përfshirjen e kostove të pranueshme të parashikuara në këtë udhëzim, në skemën e masave mbështetëse që financohen nga buxheti vjetor i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, i alokuar për këtë qëllim.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Frida Krifca